

KAPITULLI I I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Parimet themelore

Kryqi i Kuq i Kosovës është Shoqatë e pavarur, humanitare, vullnetare dhe joprofitabile, e themeluar në vitin 1945. Kryqi i Kuq i Kosovës (në tekstin e mëtejme KKK) vepron në bazë të Ligjit nr. Ligjit nr. 03/L-179 të datës 10 Qershor 2010 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. KKK veprimtarinë e vet e mbështet në parimet e Ligjit Ndërkombëtar, Humanitar, gjegjësisht të konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokoleve shtesë të vitit 1977 si dhe në Parimet Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe, Kushtetutës së Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe, Rezolutave të Këshillit të Delegeve dhe vendimeve të Kuvendit të Përgjithshëm të Federatës dhe Statutit të Lëvizjes.

Humanizmi

E lindur nga dëshira për t'u ardhur në ndihmë të gjithëve pa asnjë dallim, në luftë dhe në paqë. Lëvizja Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe, në planin ndërkombëtar dhe kombëtar, përpiqet në çdo rrethanë të parandalojë dhe të lehtësojë vuajtjet e njerëzve. Ajo synon mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njeriut si dhe respektimin e tij; përkrah mirëkuptimin e ndërsjellët, miqësinë, bashkëpunimin dhe një paqe të qëndrueshme ndërmjet popujve.

Paanësia

Lëvizja nuk bënë asnjë dallim për arsye kombësie, race, feje, gjendjeje shoqërore apo përkatësie politike dhe ideologjike. Ajo përpiqet të lehtësojë vuajtjet e individëve, duke u udhëhequr vetëm nga nevojat e tyre dhe t'u jap përparësi rasteve më urgjente të fatkeqësive.

Neutraliteti

Në mënyrë që të vazhdojë të gëzojë mirëbesimin e të gjithëve, Lëvizja nuk mund të marrë anën e askujt në gjendje lufte ose të angazhohet në çfarëdo kohe në debate të natyrës politike, racore, fetare dhe ideologjike.

Pavarësia

Lëvizja është e pavarur. Shoqata Kombëtare, ndërkohë që është ndihmuese në shërbimet humanitare të qeverisë së tyre dhe subjekt i ligjeve të vendeve përkatëse, duhet t'a ruajë gjithmonë autonominë e vet në mënyrë që të jetë në gjendje që në çdo kohë të veproj në përputhje me parimet e Lëvizjes.

Vullnetarizmi

Është një lëvizje vullnetare ndihmuese dhe në asnjë mënyrë përfituese.

Uniteti

Duhet të jetë vetëm një Shoqatë e Kryqit të Kuq ose të Gjysëmshënës së Kuqe, në një vend. Ajo duhet të jetë e hapur për të gjithë. Duhet t'a drejtojë punën e saj humanitare në të gjithë territorin e saj.

Universaliteti

Lëvizja e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmshënës së Kuqe, në të cilën të gjitha Shoqatat kanë status të barabartë, ndajnë përgjegjësi dhe detyra të barabarta duke ndihmuar njëra-tjetrën, është e përhapur kudo në botë.

Neni 2

Misioni i Kryqit të Kuq të Kosovës

- Të lehtësojë vuajtjet njerëzore të inividëve dhe bashkësive të rrezikuara përmes programeve të fokusuara, prioritare dhe të qëndrueshme si ndihmëse e autoriteteve qendrore dhe lokale, në përputhje me Parimet Themelore të Lëvizjes të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmshënës së Kuqe.

Neni 3

Statusi ligjor kombëtar

Karakteri kombëtar

Kryqi i Kuq i Kosovës (në tekstin e mëtejme KKK) ushtron veprimtarinë e tij si e vetmja Shoqatë Kombëtare e Kryqit të Kuq në Kosovë përmes degëve të Kryqit të Kuq të Kosovës, të cilat e bëjnë KKK Shoqatë unike.

KKK është Shoqatë ndihmëse e autoriteteve vendore në fushën humanitare në mbarë vendin dhe si i tillë gëzon përkrahjen e Institucioneve Qeveritare.

Institucionet Qeveritare në të gjitha kohërat respektojnë zbatimin e parimeve themelore të Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhenës së Kuqe nga KKK (neni 5 i Ligjit të KKK)

KKK është Shoqatë me strukturë ligjore. Ka status ligjor. KKK ka një kohëzgjatje të pakufizuar.

KKK ka selinë në Prishtinë, Rr.Tirana nr.27.

Neni 4

Marrdhëniet me komponentet tjera të Lëvizjes

Karakteri Ndërkombëtar

Kryqi i Kuq i Kosovës bashkëpunon drejtëpërdrejtë me komponentët e Lëvizjes, ka të drejtë dhe obligim që të përfaqësojë anëtarët dhe interesat e veta në Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) dhe Federatën Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhenës së Kuqe (Federata).

Kryqi i Kuq i Kosovës i përmbushë obligimet e përcaktuara në nenin 4 të Statutit të Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhenës së Kuqe.

Marrdhëniet e KKK me komponentet e Lëvizjes janë konform kushteve të përcaktuara në nenin 3 të Statutit të Lëvizjes.

KKK duke qenë pjesë e Federatës obligohet të përmbushë detyrat e përcaktuara sipas nenin 8 të Kushtetutës së Federatës.

Neni 5

Marrëveshjet

KKK nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me organizata, veçmas me autoritetet vendore të Kosovës, të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e shërbimeve publike. Këto marrëveshje bëhen me shkrim dhe në asnjë mënyrë nuk e obligojnë KKK të veprojnë në kundërshtim me Parimet Themelore.

Neni 6

Emblema e KKK

Emblema e KKK është, Kryqi i Kuq me pesë katrorë të barabartë në sfond të bardhë. Kryqi i Kuq i Kosovës përdorë shenjën e Kryqit të Kuq në përputhje me nenin 6 të Ligjit të Kryqit të Kuq të Kosovës si dhe nenin 5 dhe 6 të Ligjit për Përdorimin dhe Mbrojtjen e Emblemës të Kryqit të Kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve në pajtim me Konventat e Gjenevës të vitit 1949, me Protokollet e tyre Shtesë dhe me rregulloret e vitit 1991 mbi përdorimin e emblemës nga Shoqatat Kombëtare. Flamuri i Kryqit të Kuq është pëlhurë e bardhë në formë katërkëndëshi në mesin e të cilit është shenja e Kryqit të Kuq, madhësia e të cilës është në proporcion me madhësin e flamurit.

Neni 7

Struktura

Kryqi i Kuq i Kosovës përbëhet nga Organet Qëndrore dhe degët e KKK.

- Kuvendi i Përgjithshëm
- Kryesia Qendrore

Struktura në degën e KKK:

- Kuvendi i Degës së KKK
- Kryesia e Degës së KKK.

KAPITULLI II

Neni 8

Objektivi i përgjithshëm

Qëllimi kryesor i Kryqit të Kuq të Kosovës është parandalimi dhe lehtësimi i vuajtjeve me paanësi të plotë, duke mos bërë asnjë lloj diskriminimi në baza fetare, gjuhësore, kombëtare, racore, gjinore, prejardhjeje shoqërore apo ideve dhe bindjeve politike.

Për këtë qëllim, detyrat dhe synimet e KKK janë:

1. **Të veprojë në pajtim me Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949 dhe Protokollet Shtesë për ndihmë viktimave, në konfliktet e armatosure dhe në kohë paqjeje.**
2. Brenda sferës së planit kombëtar, **KKK me veprimtari të posaçme angazhohet në situata të fatkeqësive natyrore, ekologjike dhe fatkeqësive të tjera me përmasa të gjëra, epidemive dhe konflikteve të armatosura.**
3. Zhvillon aktivitete në fushën e Shërbimit të Kërkimeve dhe përgatitet për veprim konformë Ligjit.
4. Të kontribuojë në përmirësimin e mirëqenjes sociale, me organizimin e aksioneve solidare në bashkëpunim me partnerët vendor dhe ndërkombëtar.
5. Të ndihmojë në mbrojtjen shëndetësore të popullatës dhe parandalimin e sëmundjeve përmes realizimit të programeve dhe projekteve nga fusha e shëndetësisë në koordinim me Ministrinë dhe institucione shëndetësore.
6. Të vetëdijësoj popullatën për dhurim vullnetar të gjakut.
7. Të trajtojë dhe çertifikojë ligjëruesit e për projektin e Ndihmës e parë.
8. Të aftësojë dhe çertifikojë në ndihmën e parë kandidatët të cilët aplikojnë për patent shofer.
9. Të bëjë aftësimin e popullatës së kategorive të ndryshme për ofrimin vullnetar të ndihmës së parë në të gjitha mjediset.
10. Të inkurajojë dhe përkrah pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjëve në veprimtarinë e Kryqit të Kuq, duke nxitur aktivizimin e tyre në të gjitha nivelet e organizimit të shoqatës.
11. Të promovojë frymën humanitare të paqes, rrespektit, mosdiskriminimit, barazisë gjinore dhe mirëkuptimit në mesin e popullatës, në veçanti në mesin e fëmijëve

- dhe të rinjëve përmes informimit me Parimet Themelore të Lëvizjes dhe të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar.
12. Të zhvillojë rrjetin organizativ në të gjitha nivelet për të përmbushur kërkesat e Shoqatës Kombëtare që të funksionon më mirë në të gjitha pjesët e Kosovës.
 13. Të rekrutojë, trajnojë, caktojë personelin dhe vullnetarët, të cilët duhet të jenë të gatshëm për kryerjen dhe përmbushjen e të gjitha detyrave, të cilat i janë besuar dhe parashtrohen para Kryqit të Kuq të Kosovës.
 14. Të dizajnojë, implementojë politikat e KKK duke u bazuara në politikat e miratuara te Federatës.
 15. Të bashkëpunon me autoritetet publike për të siguruar respektimin e Ligjit ndërkombëtar humanitar dhe mbrojtjen e emblemave të Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës së Kuqe dhe Kristalit të Kuq.
 16. Të botoj publikime nga veprimtaria e vet, të bëjë informimin e anëtarësisë dhe popullatës mbi idetë dhe veprimtarinë e vet duke siguruar njëkohësisht transparencë të plotë.
 17. Ngritë vetëdijësimin e popullatës për mbrojtje të ambientit.
 18. **Të bëjë vetëdijësimi e popullatës nga minat, mjetet e pashpërthvera, armët e vogla dhe të lehta.**
 19. **Të bëjë vetëdijësimin e popullatës për mbrojtje në komunikacion.**

KAPITULLI III

Përbërja e Shoqatës

Neni 9

Anëtarët

Anëtarësia në Shoqatën Kombëtare është e hapur për të gjithë pa asnjë diskriminim të bazuara në racë, gjini, besim fetar, gjuhë, klasë apo ide politike.

Anëtarët e Kryqit të Kuq të Kosovës mundën me qen:

- Anëtarë aktiv

Anëtarë aktiv janë ata persona, të cilët e pranojnë Statutin dhe pajtohen që të ofrojnë shërbimet e tyre KKK si dhe paguajnë anëtarësinë në degën e KKK.

- Anëtarë ndihmës

Anëtarë ndihmës mund të jenë shtetasit e Kosovë dhe të huaj, personat juridik të cilët ndihmojnë KKK në vëmpritarinë humanitare (me patronate ose forma të tjera ndihmëse).

- Anëtarë nderi

Anëtarë nderi janë ata persona, të cilët janë shpallur si të tillë nga Kuvendi i Përgjithshëm me propozimin e Kryesisë, për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm në KKK.

Neni 10

Kriteret e anëtarimit

Anëtarë aktiv i Kryqit t Kuq të Kosovës mund të bëhet personi i cili:

- Pranon Parimet Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të KK dhe GJK.
- Pranon dhe respekton Statutin e KKK.
- Pagan anëtarësinë e Shoqatës në Degën e KKK.

Neni 11

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve

Te drejtat e anëtarëve:

- Të zgjedhin dhe të zgjedhen në organet drejtuese, përveç atyre të cilët janë të punësuar në KKK.
- Të marrin pjesë dhe të votojnë në Kuvendet e degëve të KKK dhe nëse zgjedhen si delegat, edhe në Kuvendin e Përgjithshëm të KKK.
- Të paraqesin mendime dhe propozime për avansimin e punës së Shoqatës në çdo nivel të organizimit të saj.

Detyrat e anëtarëve:

- Të mbështesin dhe të përhapin njohuritë për Parimet Themelore të Lëvizjes.
- Të përkrahin punën e Shoqatës.
- Të njohin dhe të respektojnë Statutin e Shoqatës.
- Të paguajnë anëtarësinë vjetore.
- Të marrin pjesë në mënyre aktive në punën e Shoqatës Kombëtare, duke ruajtur dhe afirmuar imazhin e saj.
- Të respektojnë Kodin e mirësjelljes për anëtarët.

Neni 12

Humbja e statusit të anëtarit

Anëtari mund ta humb statusin e anëtarit të KKK nëse:

- Jep dorëheqje me shkrim.
- Nuk paguan anëtarësinë deri në fund të sejcilit vit kalendarik.
- Përrjashtohet nga Dega e KKK për:
 - Shkelje të rëndë të Parimeve Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të KK dhe GJK
 - Shkelje të Statutit të KKK
 - Kryerjen e veprimeve të cilat cenojnë rëndë imazhin e Shoqatës.
 - Shkelje të Kodit e Mirësjelljes

Vendimin për përjashtimin e anëtarit e merrë Kryesia e Degës së KKK.

Çdo anëtarë i përjashtuar duhet të informohet saktë dhe me shkrim për shkaqet e përjashtimit nga Kryesia e Degës së KKK.

Anëtari aktiv duhet të marrë një përkujtues për pagesën e anëtarësis një muaj para skadimit të afatit.

Çdo anëtarë i përjashtuar ka të drejtë të apelojë në Kryesinë Qendrore në afat prej 30 ditësh prej ditës së përjashtimit.

Kryesia Qendrore vendos për rregullat e procedurës për dëgjim të ankesave.

KAPITULLI IV

Neni 13

Organet drejtuese qendrore

Kuvendi i Përgjithshëm

Kuvendi Përgjithshëm përfaqëson tërësinë e Kryqit të Kuq të Kosovës dhe përbëhet nga Delegatët e deleguar.

Delegatët për Kuvendin e Përgjithshëm zgjedhen nga Kuvendet e degëve të KKK dhe Institucioneve, puna e të cilave ndërlidhet me veprimtarinë e KKK si: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Forcës dhe Sigurisë të Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme – Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave, Ministria e Infrstrukturës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, Univerziteti, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, Qendra

Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut. Delegatët nga institucionet e lartpërmendura delegohen mvarësisht prej kërkesës me shkrim të Kryqit të Kuq të Kosovës me nga një përfaqësues.

Numri i delegatëve nga Degët përcaktohet me propozim të Kryesisë së Kryqit të Kuq të Kosovës në përpjestim me madhësinë e Degës së KKK (minimumi një dhe maksimumi tre delegatë), duke pasur parasysh përfaqësimin adekuat gjinor, moshës dhe profileve.

Neni 14

Kuvendi i Përgjithshëm është organi më i lartë i Kryqit të Kuq të Kosovës. Ai vendos për të gjitha çështjet e përfshira në rendin e ditës me propozim të Kryesisë si dhe propozimet e degëve të Kryqit të Kuq të Kosovës.

Mandati i anëtarëve të Kuvendit është 4 (katër) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe një mandat.

Neni 15

Kompetencat

- Miraton Statutin e Kryqit të Kuq të Kosovës,
- Propozon Ligjin e Kryqit të Kuq të Kosovës dhe ligjet e tjera që kanë lidhje me të.
- Përcakton dhe aprovon Misionin dhe Vizionin, Strategjinë dhe politikat e veprimtarisë që drejtojnë veprimtarinë e Shoqatës Kombëtare.
- Diskuton dhe miraton raportin e Kryetarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm mbi veprimtarinë e KKK për periudhën mes dy seancave të Kuvendit.
- Miraton planet, buxhetet, aktivitetet dhe raportet financiare të KKK.
- Miraton raportin e Komisionit financiar.
- Miraton programin e KKK për përgatitje në rastet e konflikteve të armatosura dhe fatkeqësive natyrore.
- Miraton Rregulloren mbi funksionimin e Kuvendit të Përgjithshëm dhe Kryesisë Qendrore.
- Zgjedhë anëtarët e Kryesisë Qendrore nga rradhët e delegatëve të Kuvendit.
- Zgjedhë Kryetarin dhe Zëvendëskryetarin.
- Zgjedhë Kryetarin dhe anëtarët e komisionit për financa.

- Miraton Rregulloren për mirënjohje dhe falenderime për organizata dhe individë për kontributin e tyre në aktivitetet e KKK si dhe për donatorë.

Neni 16

Seancat

Kuvendi i Përgjithshëm mblidhet më së paku çdo dy vjet në seanca të rregullta punuese, ndërsa çdo katër vjet në seancat zgjedhore. Kuvendi i Përgjithshëm mund të mblidhet në raste të jashtëzakonshme edhe me iniciativën e Kryetarit në marrëveshje me Kryesinë Qendrore ose me kërkesën e së paku 1/3 të anëtarëve të Kuvendit të Përgjithshëm.

Neni 17

Procedurat

Kuvendi i Përgjithshëm i merr të gjitha vendimet e plotëfuqishme në prani të së paku 2/3 të delegatëve të saj dhe me votat e shumicës të delegatëve të pranishëm të cilët kanë të drejtë vote. Në të kundërtën caktohet seanca e re e Kuvendit.

Çdo delegat i Kuvendit të Përgjithshëm ka të drejtën e një vote.

KAPITULLI V

Neni 18

Kryesia Qendrore

Kryesia Qendrore është organ që drejton Kryqin e Kuq të Kosovës ndërmjet sesioneve të Kuvendit të Përgjithshëm.

Përbëhet nga :

- Kryetari
- Zëvendëskryetari
- Anëtarët e Kryesisë të zgjedhur në Kuvend

Numri i anëtarëve të Kryesisë së ardhshme caktohet me vendim të Kryesisë paraprake.

Neni 19

Kompetencat

Kryesia Qendrore vendos për të gjitha çështjet e rëndësishme për përmbushjen e qëllimeve të KKK. Zbaton politikën e përgjithshme të KKK për të cilën përgjigjet para Kuvendit të Përgjithshëm.

- Zbaton politikat e KKK .
- Aprovon Kodin e Mirësjelljes për anëtarët, vullnetarët, anëtarët e Kryesisë, Kryetarin dhe Zëvendëskryetarin dhe për të punësuarit në KKK.
- Përcakton dhe miraton politikat e programeve të KKK.
- Miraton Rregulloret dhe aktet tjera të nevojshme për veprimtarinë e KKK
- Shqyrton nevojën dhe propozon ndryshime dhe plotësime në Statutin e KKK për Kuvend të Përgjithshëm.
- Merr vendim për formimin e komisioneve të caktuara, të nevojshme dhe të përshtatshme për realizimin e detyrave të KKK.
- Miraton planet financiare dhe siguron që përdorimi burimeve financiare e materiale të jetë në pajtim me parimet e Lëvizjes.
- Vendos për themelimin dhe shuarjen e degëve.
- Mbikëqyr veprimtarinë e degëve të KKK, në raste të domosdoshme vendos për shpërbërjen e Kryesisë dhe Kuvendit të degës, në përputhje me nenin 28 dhe 32, dhe shpall zgjedhje të reja të parakohshme në degë.
- Merr vendime për përparësitë dhe dinamikën e zhvillimit të veprimtarisë së KKK.
- Jep pëlqimin për emërimin e Sekretarëve të degëve të KKK dhe jep mendimin për shkarkim.
- Miraton dhe ndryshon rregulloret për të bërë sa më efektiv Statutin e KKK.
- Përcakton kahjet e bashkëpunimit me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe si dhe Shoqatat Kombëtare.
- Vendos për mirënjohje dhe falenderime me propozim të Kryetarit, Kryesisë dhe degëve të KKK në bazë të Rregullores së miratuar nga Kryesia e KKK.
- Vendos mbi shumën e pagesës së anëtarësisë në KKK.
- Emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm të KKK

- Miraton aktet normative mbi sistematizimin e vendeve të punës dhe të ardhurat e të punësuarëve në shërbimet profesionale të KKK, në nivel qendror dhe lokal.

Neni 20

Seancat

Kryesia Qendrore mban seancë të rregullt me thirrjen e Kryetarit së paku një herë në tre muaj. Kryesia mund të mbajë seancë edhe jashtë rradhës me kërkesën e Kryetarit, $\frac{1}{3}$ të anëtarëve të saj, Kryesive të Degëve ose me kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm drejtuar Kryetarit.

Neni 21

Procedurat

Kryesia Qendrore i merrë të gjitha vendimet në prani të më shumë se gjysmës të anëtarëve të vet dhe me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Çdo anëtar i Kryesisë Qendrore ka të drejtën e një vote.

Në mungesë të kuorumit, seanca shtyhet, seanca e re mbahet brenda afatit prej 30 ditësh sipas procedurës së paraparë. Në raste emergjente Kryesia vendos edhe me më pak anëtarë.

Neni 22

Kryetari

Kryetari është personaliteti më i lartë i KKK.

Kryetari është përgjegjës para Kuvendit të Përgjithshëm për të siguruar se KKK ushtron objektivat e përcaktuara me Statut. Kryetari vepron nën autoritetin e Kuvendit të Përgjithshëm dhe Kryesisë Qendrore për drejtimin e KKK në përputhje me vendimet që janë marrë.

Funksionet e Kryetarit janë:

- Të thërret dhe të kryesoj seancat e Kuvendit të Përgjithshëm dhe të Kryesisë Qendrore.
- T'i paraqesë Kuvendit të Përgjithshëm një pasqyrë të gjendjes të KKK.
- Të bashkërendoj punën e organeve të KKK.

- Të përfaqësoj KKK në rrafshin kombëtarë ashtu edhe ndërkombëtarë.
- Të zbatoj çdo detyrë tjetër të besuar nga Kuvendi i Përgjithshëm ose nga Kryesia Qendrore.
- Kryetari mund t'ia kalojë një pjesë të këtyre detyrave, të shprehura në këtë nen, Zëvendëskryetarit.

Në rast të mungesës së Kryetarit ose në rast se Kryetari nuk është në gjendje të kryejë këtë funksion (për shkaqe shëndetësore apo të tjera), funksionin e Kryetarit e kryen Zëvendëskryetari deri në kthimin e tij, ose deri në seancën e rradhës së Kuvendit të Përgjithshëm.

Neni 23

Zëvendëskryetari

Ushtron funksionin në bazë të obligimeve të përcaktuara me Statut nga Kryesia Qendrore e KKK dhe Kryetari.

Neni 24

Komisioni për financa

Komisioni për financa emërohet nga Kuvendi i Përgjithshëm dhe ka mandat katër vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat (dy mandate të njëpasnjëshme). Komisioni përbëhet nga kryetari i komisionit dhe katër anëtarë, nga rradhët e ekspertëve për financa të propozuar nga Kryesia e KKK. Detyra e komisionit financiar është: të kontrollojë veprimtarinë materiale-financiare në të gjitha nivelet e organizimit të KKK.

Anëtarët e komisionin financiar duhet të jenë anëtarë të KKK, por jo delegatë të Kuvendit.

Neni 25

Komisioni për financa, punën e vet e koordinon me Kryesinë Qendrore dhe Sekretarin e Përgjithshëm. Raportet periodike dhe vjetore financiare i'a paraqet Kryesisë Qendrore për shqyrtim dhe miratim, ndërsa raportet dy dhe katër vjeçare financiare i'a paraqet Kuvendit të Përgjithshëm.

Neni 26

Sekretari i Përgjithshëm

- Emërohet dhe shkarkohet nga Kryesia Qendrore sipas kriterëve të përcaktuara më parë.
- Sekretari i Përgjithshëm është kryesues i menagjimit, drejton dhe është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Përgjithshëm dhe të Kryesisë Qendrore.
- Është përgjegjës për punën e përditshme dhe shërbimin profesional të Zyrës Qendrore.
- Është përgjegjës për emërimin dhe shkarkimin e personelit të shërbimeve (sipas procedurave të parapara me Ligje).
- Përgatitë planin financiar (buxhetin) orientues për 6 muaj ose 1 vit si dhe të gjitha rregullat e nevojshme për mbarëvajtjen e punës të KKK.
- Raporton për gjendjen financiare periodike në bashkëpunim me Komisionin Financiar.
- Përcakton strukturën e shërbimit profesional dhe e paraqet për miratim në Kryesinë Qendrore.
- Lidhë kontrata me punonjësit e shërbimit profesional.
- Është përfaqësues i autorizuar i KKK në lidhje me palët e treta.
- Sekretari i Përgjithshëm është i obliguar që ta mbajë të informuar Kryetarin për veprimet e bëra në Kryqin e Kuq.
- Sekretari i Përgjithshëm nuk është anëtar i Kryesisë Qendrore.

Sekretari i Përgjithshëm, është Sekretar i Kuvendit të Përgjithshëm dhe i Kryesisë Qendrore.

Sekretari i Përgjithshëm duhet të marrë pjesë në seancat e Kuvendit të Përgjithshëm dhe Kryesisë Qendrore në postin e këshilltarit pa të drejtë vote.

Stafi profesional i ndihmon Sekretarit të Përgjithshëm për zbatimin e detyrave ekzekutive të tij.

Mandati i Sekretarit të Përgjithshëm është 4 vjet me mundësi të riemërimit.

KAPITULLI VI

DEGA E KKK

Neni 27

Organizimi dhe roli i Degës së Kryqit të Kuq të Kosovës

Dega është njësi bazë e Kryqit të Kuq të Kosovës,

Dega themelohet me vendimin e Kryesisë Qendrore (neni 19) për të siguruar praninë e veprimtarisë së KKK në gjithë territorin e vendit duke pasur parasysh ndarjen administrative.

Dega përbëhet nga anëtarët e Kryqit të Kuq të Kosovës të regjistruar në territorin e saj të veprimit. Dega organizon veprimtarinë e vet në territorin përkatës konform Statutit.

Dega, në territorin e saj administrativ ku ka anëtarë dhe veprimtari të mjaftueshme, themelon nëndegë të drejtuara nga një këshill që zgjedhet nga përbërja e anëtarëve të saj. Këto nëndegë janë nën autoritetin e Degës dhe nuk mund të kenë pavarësi financiare.

Neni 28

Kuvendi i Degës

Kuvendi është organi më i lartë i Degës dhe përfaqëson tërësinë e anëtarëve të saj.

Vendos për të gjitha çështjet me interes për Kryqin e Kuq të Kosovës në nivel të degës. Në territorin përkatës administrativ Kuvendi i Degës përbëhet nga delegatët e degës së kryqit të kuq dhe Institucionet me të cilat bashkëpunon kryqi i kuq. Kryesia e Degës përcakton numrin e delegatëve, profilet dhe kriteret për përfaqësim në Kuvend. Zgjedh Kryetarin, Zëvendëskryetarin dhe Kryesinë në harmoni me dispozitat e Statutit të Kryqit të Kuq të Kosovës.

Zgjedh delegatët për në Kuvendin e Përgjithshëm sipas numrit dhe profilit të caktuar nga Kryesia Qendrore.

Mandati i Anëtarëve të Kuvendit është katër (4) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat.

Kompetencat:

Kuvendi diskuton dhe aprovon raportin e punës, planin e punës së Degës për periudhën në mes dy kuvendeve zgjedhore.

Miraton raportin dhe planin financiar mes dy kuvendeve zgjedhore.

Shpërbërja

Kryesia Qendrore në bazë të kompetencave nga neni 19 mund të shpërbëjë Kuvendin e degës të Kryqit të Kuq nëse:

- Shkelen normat statutare dhe rregulloret e brendshme
- Ka mosmarrëveshje të rënda në nivel dege
- Nuk funksionojnë sisteme të caktuara për vendosje dhe zhvillim të Kryqit të Kuq
- Për të gjitha veprimet tjera jo të mira të cilat i konstaton Kryesia Qendrore e KKK në bazë të raporteve nga komisionet e formuara për shqyrtim

Neni 29**Seancat**

Kuvendi i Degës mban seanca të rregullta punuese çdo dy vjet.

Kuvendi mund të mbajë seanca në rast nevoje, me iniciativën e Kryetarit në marrëveshje me Kryesinë e Degës me kërkesën e një të tretës ($\frac{1}{3}$) së anëtarëve të Kuvendit apo me kërkesën e Kryesisë Qendrore të KKK-së.

Neni 30**Procedurat**

Kuvendi i Degës merr vendime të plotëfuqishme në prani të së paku $\frac{2}{3}$ e delegateëve të pranishëm me të drejtë vote. Në mungesë të kuorumit, seanca shtyhet, seanca e re mbahet brenda afatit prej 30 ditësh sipas procedurës së paraparë. Çdo delegat i kuvendit të Degës ka të drejtën e një vote.

Neni 31

Kryesia e Degës

Kryesia e Degës është organ që udhëheq me veprimtarinë e KKK-së në nivel të Degës mes dy kuvendeve zgjedhore.

Kryesia përbëhet nga:

Kryetari

Zëvendëskryetari dhe

Anëtarët e kryesisë të zgjedhur në Kuvend.

Numri i anëtarëve të Kryesisë së ardhshme caktohet me vendim të Kryesisë paraprake.

Neni 32

Kompetencat

Kryesia e Degës vendos për të gjitha çështjet e rëndësishme për punën e Kryqit të Kuq në nivel të Degës.

- Mbikëqyr zbatimin e politikave të përcaktuara nga Kryesia Qendrore e KKK.
- Zbaton Kodin e Mirësjelljes për anëtarët, vullnetarët, anëtarët e Kryesisë, Kryetarin, zv. Kryetarin dhe të punësuarit e Degës.
- Merr vendime të mirëfillta të nevojshme për veprimtarinë e Degës.
- Merr vendim për formimin e komisioneve të nevojshme dhe adekuate për realizimin e detyrave të Degës.
- Shqyrton dhe aprovon raportet e punës dhe financiare, planet e punës dhe financiare.
- Siguron që përdorimi i mjeteve financiare e materiale janë në pajtim me parimet dhe politikat e KKK-së.
- Emëron sekretarin e Degës në bazë të pëlqimit të Kryesisë Qendrore të KKK-së (neni 19) dhe shkarkon Sekretarin e Degës.
- Mban kontakte të rregullta, bashkëpunon, informon Kryesinë Qendrore dhe zbaton vendimet e KKK.

Shpërbërja

Kryesia Qendrore në bazë të kompetencave nga neni 19 mund të shpërbëjë Kryesinë e degës të Kryqit të Kuq nëse:

- Shkelen normat statutare dhe rregulloret e brendshme
- Ka mosmarrëveshje të rënda në nivel të degës
- Nuk funksionojnë sisteme të caktuara për vendosje dhe zhvillim të Kryqit të Kuq
- Për të gjitha veprimet tjera jo të mira të cilat i konstaton Kryesia Qendrore e KKK në bazë të raporteve nga komisionet e formuara për shqyrtim

Neni 33

Seancat

Kryesia e Degës mban seancë të rregullt me thirrjen e kryetarit së paku një herë në tre muaj.

Kryesia mund të mbaj seancë edhe jashtë rradhës me kërkesën e kryetarit apo $\frac{1}{3}$ e anëtarëve të saj, edhe me kërkesën e Sekretarit të Degës, drejtuar Kryetarit.

Seanca e Kryesisë së Degës mund të konvokohet edhe me kërkesën e Kyesisë Qendrore të KKK-së.

Neni 34

Procedurat

Kryesia e Degës, të gjitha vendimet i merr në prani të më shumë se gjysmës së anëtarëve të pranishëm.

Çdo anëtar i Kryesisë së Degës ka të drejtën e një vote.

Në mungesë të kuorumit, seanca shtyhet, seanca e re mbahet brenda afatit prej 30 ditësh sipas procedurës së paraparë. Në raste emergjente kryesia vendos edhe me më pak anëtarë.

Neni 35

Kryetari i Degës

Kryetari është personaliteti më i lartë i Degës së KKK.

Kryetari është përgjegjës para Kuvendit të Degës, për të siguruar se KK i Degës ushtron detyrat, objektivat e përcaktuara me Statut.

Kryetari vepron nën autoritetin e Kuvendit dhe Kryesisë për drejtimin e KK të Degës, në përputhje me vendimet që janë marrë.

Funksionet e Kryetarit janë:

- Të thërret dhe të kryesojë seancat e Kuvendit dhe të Kryesisë së Degës.
- T'i paraqet Kuvendit dhe Kryesisë një pasqyrë të gjendjes së përgjithshme të KK të Degës.
- Të mbikëqyr realizimin e veprimtarisë të degës së KKK.
- Të përfaqësoj Kryqin e Kuq të Degës në nivel të saj.
- Kryetari në rast nevojë mund t'ia bartë një pjesë të detyrave zv. Kryetarit.

Zv. Kryetari

Në rast të mungesës së Kryetarit ose në rast se Kryetari nuk është në gjendje të kryejë këtë funksion (për shkaqe shëndetësore apo të tjera), funksionin e kryen zv. Kryetari deri në seancën e ardhshme të Kuvendit.

Neni 36

Komisioni financiar

Komisioni financiar emërohet nga Kuvendi i Degës dhe ka mandat 4 vjeçar me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat (dy mandate të njëpasnjëshme).

Komisioni përbëhet nga Kryetari dhe dy anëtar ekspert për financa.

Anëtarët e komisionit financiar duhet të jenë anëtar të KKK-së por jo delegat të Kuvendit.

Detyra e komisionit financiar është të kontrollojë veprimtarinë material, financiare të Degës.

Neni 37

Komisioni financiar, punën e vet e koordinon me Kryesinë dhe Sekretarin e Degës. Komisioni i paraqet Kuvendit dhe Kryesisë së Degës raportet financiare për shqyrtim dhe miratim. Pa verifikimin e komisionit raportet financiare nuk janë valide edhe nëse i aprovon Kuvendi apo Kryesia.

Neni 38

Sekretari i Degës

- Emërohet nga Kryesia e Degës (me pëlqimin e Kryesisë Qendrore, neni 19) dhe shkarkohet nga Kryesia e Degës.
- Sekretari drejton dhe është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Kuvendit dhe Kryesisë së Degës.
- Është përgjegjës për punën e përditshme dhe shërbimin profesional të Degës.
- Në marrëveshje me Zyrën Qendrore bënë pranimin dhe largimin e personelit sipas procedurave Ligjore.
- Lidhë kontratë me të punësuarit e shërbimit profesional të Degës.
- Raporton për punën e bërë në degë dhe planet e punës për Kryesi apo Kuvend.
- Propozon planin financiar dhe raporton për gjendjen financiare në bashkëpunim me komisionin financiar për Kryesi apo Kuvend.
- Është përgjegjës dhe raporton në Zyrën Qendrore.
- Sekretari është i obliguar që të mbajë të informuar, për veprimet e bëra në KK, Kryetarin e Degës.
- Sekretari nuk është anëtar i Kryesisë.
- Sekretari duhet të përgatitë dhe të merr pjesë në seancat e Kuvendit dhe Kryesisë së Degës.
- Ndihton punën e seancave pa të drejtë vote.
- Mandati i sekretarit të Degës është 4 vjeçar me mundësi të riemërimit.

Neni 39

Mjetet financiare në degë mund të realizohen nga:

- Anëtarësia
- Të falurat dhe trashëgimia
- Nga projektet e ndryshme
- Nga fondi i solidaritetit të Drejtoratit për Mirëqenie Sociale.
- Nga aksionet tradicionale

Dega nuk pranon donacione që burojnë drejtëpërdrejtë nga të ardhurat e veprimtarive që bien ndesh me Parimet Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysëhënës së Kuqe.

KAPITULLI VII

ZGJEDHJET – ROTACIONI – PROFILET

Neni 40

Zgjedhjet-rotacioni

Zgjedhja e Kryetarit, Zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të Kryesisë së KKK bëhet nga Kuvendi i Përgjithshëm me shumicën absolute të votave të anëtarëve të pranishëm.

Votimi bëhet me vota të fshehta. Kuvendi mund të vendos ndryshe.

Zgjedhjet për të njëjtat poste në degët e KKK bëhen nga Kuvendet e degëve të KKK me procedurë të njëjtë sikurse për Kuvendin e Përgjithshëm të KKK.

Kohëzgjatja e mandatit të Kryetarit, Zv.kryetarit dhe anëtarëve të Kryesisë në nivel Qendror dhe ato komunale është katër (4) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat (dy mandate të njëpasnjëshme).

Profilet

Biografia e kandidatëve duhet t'i dërgohet Kryesisë aktuale para se të mbahen zgjedhjet për postet e rëndësishme (Kryetari, Zv.kryetari dhe anëtarët e Kryesisë) në nivel qendror dhe lokal. Kandidatët zgjedhen në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- Niveli i arsimimit
- Eksperiencia në Kryqin e Kuq të Kosovës.

- Të mos ketë konflikte interesi midis postit të kandidatëve duke ruajtur integritetin e KKK si Organizatë apolitike.
- Te mos ketë konflikte interesi për shkak të marrëdhënieve të ngushta familjare që cenojne lirinë e tij\ saj për të zbatuar detyrat e tij\ saj në përputhje me Parimet Themelore.
- Një profil i cili shton larminë e përbërjes (të dhënat personale dhe profesionale).
- Anëtarët e zgjedhur në organet qeverisëse të Kryqit të Kuq të Kosovës në nivel qendror dhe lokal janë të obliguar të pranojnë dhe nënshkruajnë kodin e mirësjelljes.

KAPITULLI VIII

PASURIA DHE FINANCAT

Neni 41

Kryqi i Kuq i Kosovës posedon patundshmëri në pronësi të përhershme. Me këtë pasuri udhëheq Kryesia respektivisht Kuvendi i Kryqit të Kuq të Kosovës. Për tjetërsimin e pasurisë në nivel lokal dhe Qendror, kompetent është vetëm Kuvendi i Kryqit të Kuq të Kosovës.

Neni 42

Për pasurinë lëvizëse dhe të mirat tjera materiale, vendos Kryesia Qendrore e KKK.

Neni 43

Financat

Për aktivitetet për ngritjen e fondeve, për të përmbushur mandatin e vet humanitar, Kryqit të Kuq të Kosovës mund të kontaktojë organizata shërbyese si dhe të

kontraktobjë punë shërbyese për përfitime materiale konform Ligjit për veprimtarinë e Kryqit të Kuq të Kosovës.

Neni 44

Mjetet financiare në nivel qendror mund të realizohen nga:

- Anëtarësia
- Të falurat dhe trashëgimia
- Nga projekte të ndryshme
- Nga lotaria dhe lojrat e fatit
- Të hyrat me Marrëveshjet të Bashkëpunimit me Ministritë përkatëse
- Nga akcionet tradicionale
- Nga Organizatat Ndërkombëtare dhe Shoqatat Nacionale simotra
- Nga implikimet buxhetore sipas Ligjit të KKK.
- Të tjera.

KKK nuk pranon donacione që burojnë drejtëpërdrejtë nga të ardhurat e veprimtarive që bien ndesh me Parimet Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysëhënës së Kuqe.

Neni 45

Për drejtimin e pasurisë dhe financave Kryesia e KKK dhe Zyra Qendrore, obligohen të raportojnë për çdo dy vite kalendarike në bashkëpunim me komisionin për financa para Kuvendit të Kryqit të Kuq të Kosovës.

Kryqi i Kuq i Kosovës siguron auditim të jashtëm financiar në baza vjetore.

KAPITULLI IX

Neni 46

Dispozitat e përfundimtare

Propozimet për ndryshimin e Statutit bëhen nga:

- Kryesia Qendrore e KKK
- Degët e KKK (së paku nga 1\4)

Propozimet për ndryshime dhe plotësime të Statutit nga Kryesia Qendrore e Kryqit të Kuq të Kosovës u dërgohen minimumi pesëmbëdhjet ditë në shqyrtim dhe diskutim

publik degëve të Kryqit të Kuq të Kosovës. Pas kësaj procedure Statuti me të gjitha sugjerimet dhe vërejtjet i kthehet në shqyrtim edhe një herë Kryesisë Qendrore të KKK. Para se të miratohet Statuti nga ana e Kuvendit të Përgjithshëm drafti t'i dërgohet komisionit të përbashkët të Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq në Gjenevë.

Kuvendi në mbledhjen e rregullt në prani të së paku mbi 2\3 e anëtarëve, shqyrton dhe miraton ndryshimet në Statut me votimin e shumicës së delegatëve të pranishëm.

Neni 47

Rregulloret

Kryesia miraton dhe ndryshon rregulloret e nevojshme për zbatimin e këtij Statuti.

Neni 48

Dispozitat kalimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti pushon të vlejë Statuti i mëparshëm i Kryqit të Kuq të Kosovës i aprovuar me 13 mars 2005 dhe të gjitha rregulloret të cilat bien në kundërshtim me të, shfuqizohen.

Statuti hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Kuvendi i Përgjithshëm i Kryqit të Kuq të Kosovës.

Kryesia Qendrore e Kryqit të Kuq të Kosovës do të bëjë ndryshimet dhe plotësimet e Rregulloreve dhe udhëzimeve tjera për zbatim të Statutit.

Prishtinë, 01 Dhjetor 2011
Republika e Kosovës

Kryqi i Kuq i Kosovës